



**Organizata jo-qeveritare Emancipimi Civil Ma Ndryshe
EC MA NDARYSHE**

23 gusht, Prizren

**KOMUNIKATË
Përfundon cikli mujor i edukimit mbi aktivizmin në kuadër të
Shkollës së Aktivizmit Urban**

Sot është mbajtur konferenca përmbyllëse e Shkollës së Aktivizmit Urban organizuar nga EC Ma Ndryshe në kuadër të projektit “Rikthimi i Qytetit”. Shkolla e Aktivizmit Urban ka bashkuar në një proces 4 mujor të edukimit dhe aktivizmit 20 pjesëmarrës, nxënës të shkollave të mesme dhe student universiteti, të zgjedhur përmes thirrjes së hapur. Nëpërmjet Shkollës së Aktivizmit Urban, projekti ofron një platformë edukimi dhe aktivizmi qytetar për të rinjtë, duke transformuar nxënësit e shkollave të mesme në qytetarë aktiv në fushat sociale dhe politike.

Shkolla është organizuar në tre module, përmes të cilave pjesëmarrësit kanë pasur mundësi të: njihen me konceptet e aktivizmit urban përmes një sërë ligjëratash dhe prezentimesh nga ekspertë dhe aktivistë; të konceptojnë iniciativa konkrete të aktivizmit urban në kuadër të punës praktike si dhe të angazhohen në realizimin e tyre në përkrahje nga stafi i EC-it.

Gjatë konferencës përmbyllëse të Shkollës së Aktivizmit Urban është bërë rikapitulimi i përvojave të ndara në mes të pjesëmarrësve si dhe prezentimi i rezultateve të arritura përmes realizimit të iniciativave të konceptuara nga vetë nxënësit. Në përmbyllje të konferencës është bërë edhe certifikimi i pjesëmarrësve.

Poashtu gjatë kësaj konference është bërë shpallja e fituesit dhe ndarja e shpërblimit për fituesin e Garës së Videove me Smartphone. Videot pjesëmarrëse të garës janë qarkulluar në rrjetet sociale për pesë muaj me radhë, ndërsa numri i mbledhur i pëlqimeve ka përcaktuar 40% të vlerësimit total të tyre. Pjesa tjetër e vlerësimit prej 60% është bërë nga komisioni vlerësues i përbërë nga Ares Shporta - përfaqësues i Fondacionit Lumbardhi, Baris Karamuço - profesionist në fushën e video-produksionit dhe Nuhi Salihu - gazetar hulumtues. Komisioni ka vlerësuar videot në bazë të: temës dhe problematikës së adresuar, përshtatshmërisë konceptuale me projektin “Rikthimi i Qytetit” si dhe cilësisë vizuale të produktit final. Për më shumë gjeni tabelën e vlerësimeve (http://ecmandryshe.org/repository/docs/180823102655_Rezultatet.PDF)

EC përgëzon fituesen Ilirjana Qollaku dhe njëherit falënderon të gjithë pjesëmarrësit e tjerë të Garës së Videove me Smartphonë që përmes realizimit të videove të tyre kanë arritur të shpërndajnë mesazhe të fuqishme për një qytet më të mirë!

Projekti "Rikthimi i qytetit - E Drejta mbi Qytetin për grupet e nënpërfaqësuar të komunitetit në Prizren" përkrahet financiarisht nga National Endowment for Democracy.

OJQ EC Ma Ndryshe

Rr. Saraçët, Nr. 5 - Prizren

Bulevardi Nënë Tereza, H 30 B1 Nr. 5, Prishtinë

www.ecmandryshe.org & info@ecmandryshe.org

+381 38 224 967 & +381 29 222 771